LIGJ
Nr.10 361, datë 16.12.2010

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8530, DATË 23.9.1999 "PËR SHËRBIMIN POSTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8530, datë 23.9.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 8, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Operatori publik postar ka të drejtë të hapë llogari rrjedhëse dhe depozitë pa interes pranë Bankës së Shqipërisë. Afatet dhe kushtet për hapjen dhe funksionimin e llogarisë e të depozitës do të përcaktohen në marrëveshjen përkatëse, lidhur ndërmjet operatorit publik postar dhe Bankës së Shqipërisë.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6834, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi